



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) e Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6 /16 dhe 83/ 18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe neni 35, paragrafi (1) të Ligjit për Punë Devizore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/ 11, 188/ 13, 97/15, 153/15 dhe 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

V E N D I M

për mënyrën e formimit dhe publikimit të kurseve mesatare të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut

1. Me këtë vendim, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) përcakton mënyrën e formimit dhe publikimit të kurseve të këmbimit të valutave të huaja në denarë.

2. Banka Popullore formon kurset mesatare për valuta të huaja, të përcaktuara në Listën e kursit të këmbimit të Bankës Popullore (në tekstin e mëtejshëm: Lista e kursit të këmbimit) e cila është dhënë në shtojcën 1 të këtij vendimi.

Me kurset mesatare përcaktohet çmimi në denarë për një njësi valutë të huaj, i rrumbullakosur në katër numra pas presjes dhjetore.

3. Kursi mesatar i euros, për sa i përket këtij vendimi, përcaktohet çdo ditë pune në orën 16:00, si mesatare aritmetike (në tekstin e mëtejshëm: vlera mesatare) nga vlera mesatare e kuotimeve të kurseve të blerjes dhe të shitjes së euros në kundërvlerë të denarit nga bankat mbështetëse të tregut valutor, me zbatimin e formulës në vijim:

$$PV = \frac{\sum_{i=1}^n Ai}{n}$$

ku:

PV = vlera mesatare e kurseve të kuotuar të blerjes dhe shitjes së bankave mbështetëse në një ditë të caktuar;

Ai = vlera mesatare e kuotimeve të bankës mbështetëse i , e përcaktuar në pajtim me paragrafin (4) të kësaj pike;

n = numri i bankave mbështetëse të cilat kuotojnë.

Vlera mesatare nga kuotimet e bankës mbështetëse llogaritet nga kurset e kuotuar të blerjes dhe shitjes të cilat janë brenda kufijve të përcaktuar të devijimit nga kurset e ndërhyrjes së Bankës Popullore.

Margjinat e devijimit të kuotimeve të kurseve të blerjes dhe të shitjes të euros në kundërvlerë të denarit nga bankat mbështetëse të tregut valutor, përcaktohen duke hequr, respektivisht duke shtuar 0,07 denarë për euro nga kursi intervenues i blerjes, respektivisht kursi i shitjes së Bankës Popullore.

Vlera mesatare e kuotimeve të bankës mbështetëse të tregut valutor llogaritet çdo ditë pune, në orën 16:00, duke zbatuar formulën:

$$Ai = \frac{\sum_{j=1}^t \frac{Bid_{ij} + Ask_{ij}}{2}}{t}$$

$\forall Bid_{ij} \geq$ (kursi intervenues i blerjes - 0,07-) dhe $\forall Ask_{ij} \leq$ (kursi intervenues i shitjes + 0,07)

prej nga:

A_i = vlera mesatare e kuotimeve të bankës i ;

Bid = kuota e blerjes së euros nga banka i ;

Ask = kuota e shitjes së euros nga banka i ;

t = numri i kuotimeve të bankës i ;

j = numri rendor i kuotës i bankës i ;

kursi intervenues i blerjes = kuotimi i blerjes së eurove për denarë i përcaktuar nga Banka Popullore;

kursi intervenues i shitjes = kuotimi i shitjes së eurove për denarë i përcaktuar nga Banka Popullore.

Për llogaritjen e vlerës mesatare nga kuotat e kurseve blerëse dhe shitëse nga bankat mbështetëse të tregut valutor, është e nevojshme që së paku dy banka të paraqesin kuota.

Nëse një bankë mbështetëse paraqet kuota, vlera mesatare për atë ditë konsiderohet të jetë e barabartë me vlerën mesatare të ditës së mëparshme të punës.

4. Kursi mesatar për valutat tjera të Listës së kursit të këmbimit llogaritet në bazë të kurseve referente ditore të euros kundrejt valutave përkatëse, të publikuara nga Banka Qendrore Europiane.

Valutat për të cilat Banka Qendrore Europiane nuk bën llogaritje dhe nuk publikon kurs referent ditore dhe janë pjesë përbërëse e Listës së kursit të Bankës Popullore, Banka Popullore llogarit kursin mesatar të valutës së caktuar, në bazë të kurseve të tregut të publikuara në sistemet elektronike informative për tregjet financiare ndërkombëtare.

Në ditët jopune të sistemit pagesor në eurozonën TARGET2, kur Banka Qendrore Europiane nuk ka publikuar normat e referencës ditore të këmbimit, normat mesatare për të gjitha valutat llogariten në bazë të kurseve të tregut të publikuara në sistemet elektronike informative për tregjet ndërkombëtare financiare në orën 15:50.

Në ditën kur Banka Qendrore Europiane ndërpret llogaritjen dhe publikimin e kursit referues valutor për një valutë të caktuar, shkak i anëtarësimit të shtetit në Bashkimin Monetar Europian, Banka Popullore do të ndalojë llogaritjen dhe publikimin e kursit mesatar të valutës së huaj në Listën e kursit dhe kjo valutë e huaj fshihet nga Lista e kursit.

5. Banka Popullore zbaton kurset mesatare për valutat e Listës së kursit të këmbimit, nga numri rendor 1 deri në 10, duke shtuar dhe hequr nga 0,5%, si kurs për shitje dhe blerje në transaksionet me autoritetet shtetërore.

Me përjashtim nga paragrafi (1) i kësaj pike, Banka Popullore zbaton kursin mesatar nga Lista e kursit të këmbimit:

- për transaksionet e shit-blerjes me autoritetet shtetërore të cilat zhvillohen në të njëjtën ditë dhe kur për pagesat e organeve shtetërore drejt vendeve të jashtme shfrytëzohen mjete nga llogaria valutore e organeve shtetërore në Bankën Popullore, bëhen në të njëjtën valutë me të cilën bëhet pagesa,
- në rast se janë bërë transfertat nga dhe në llogaritë qarkulluese të kredisë në valutë të huaj të organeve shtetërore që mbahen në Bankën Popullore, dhe
- për transaksionet e shit-blerjes me organet shtetërore për pagesa me vende të huaja të rregulluara me marrëveshje të bëra me Bankën Popullore.

Kurset e shitjes dhe blerjes nga paragrafi (1) nga kjo pikë publikohen në faqën e internetit të Bankës Popullore.

6. Lista e kursit të këmbimit publikohet në internet faqën e Bankës Popullore, si dhe në sistemet informative elektronike të tregjeve financiare ndërkombëtare, jo më vonë se ora 18:00 çdo ditë pune dhe vlen deri në orën 00:00, deri në hyrjen në fuqi të Listës së re të këmbimit.

7. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi pushon së vlejuri Vendimi për mënyrën e formimit dhe publikimit të kurseve valutore të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/14, 102/14 dhe 14/15 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 83/22).

8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe do të zbatohet nga Lista e kursit e formuar më 1 nëntor 2022.

V. nr. 02-15/XVII-1/2022
13 tetor 2022
Shkup

Guvernatore
dhe Kryesuese
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska

Shtojca 1

Kursi i këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut
i formuar më _____ e cila zbatohet nga ora 00:00 e datës _____ deri në fillimin e vlefshmërisë së
Kursit të Ri

		Shteti	Shifra	Valuta		Njësia Valutore	Kursi mesatar në denarë
1.		UEM	978	Euro	EUR	1	
2.		SHBA	840	Dollari Amerikan	USD	1	
3.		Britania e Madhe	826	Poundi Britanik	GBP	1	
4.		Zvicra	756	Franga Zvicerane	CHF	1	
5.		Suedia	752	Korona Suedeze	SEK	1	
6.		Norvegjia	578	Korona Norvegjeze	NOK	1	
7.		Japonia	392	Jeni Japonez	JPY	1	
8.		Danimarka	208	Korona Daneze	DKK	1	
9.		Kanada	124	Dollari Kanadez	CAD	1	
10.		Australia	036	Dollari Australian	AUD	1	
11.		Bullgaria	975	Leva Bullgare	BGN	1	
12.		Republika Çeke	203	Korona Çeke	CZK	1	
13.		Hungaria	348	Forinta Hungareze	HUF	1	
14.		Polonia	985	Zloty Polonez	PLN	1	
15.		Rumania	946	Lei Rumun	RON	1	
16.		Turqia	949	Lira Turke	TRY	1	
17.		Rusia	643	Rubla Ruse	RUB	1	
18.		Brazil	986	Reali Brazilian	BRL	1	
19.		Kina	156	Juani Kinez	CNY	1	
20.		Hong Kong	344	Dollari i Hong Kongut	HKD	1	
21.		Indonezia	360	Rupia Indoneziane	IDR	1	
22.		Izraeli	376	Shekeli Izraelit	ILS	1	
23.		India	356	Rupia Indiane	INR	1	
24.		Korea Jugore	410	Voni Koreanojugor	KRW	1	
25.		Meksika	484	Peso Meksikane	MXN	1	
26.		Malajzia	458	Ringiti Malajzian	MYR	1	
27.		Zelanda e Re	554	Dollari i Zelandës së Re	NZD	1	
28.		Filipinet	608	Peso Filipineze	PHP	1	
29.		Singapuri	702	Dollari i Singapurit	SGD	1	
30.		Tailanda	764	Bahti Tailandez	THB	1	
31.		Afrika Jugore	710	Randi Afrikanojugor	ZAR	1	
32.		Serbia	941	Dinari Serb	RSD	1	
33.		Kroacia	191	Kuna Kroate	HRK	1	

